

VENDIM
Nr.38, datë 27.9.2005

MBI ZBATIMIN E MASAVE KORRIGJUESE NGA SHOQËRIA E SIGURIMEVE
“INTERSIG” SHA

Në mbështetje të shkronjave "ç" dhe "k" të pikës 2 të nenit 14 të ligjit nr.9268, datë 29.7.2004 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës së Sigurimeve" dhe të shkronjës "ë" të nenit 124 dhe të nenit 126 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" për shkelje të rënda të rregullave të menaxhimit të shoqërisë së sigurimeve INTERSIG sh.a, të përcaktuara në gërmat "ç", "d" dhe "e" të pikës 3 të nenit 126 të ligjit nr. 9267, datë 29.7.2004, si dhe për shkelje të neneve 101 pika 1 dhe 118 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004, Këshilli i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve

VENDOSI:

1. Të urdhërojë shoqërinë e sigurimeve INTERSIG sh.a. që brenda 30 ditëve nga data e këtij vendimi të realizojë:

a) Uljen e likuiditeteve në arkë deri në masën 3% të provigjoneve teknike të miratuara me vendimin e Këshillit të Autoritetit Mbikëqyrës së Sigurimeve nr.20, datë 1.4.2005.

b) Arkëtimin e paradhënies dhënë personave fizikë ose juridikë.

c) Rritjen e kapitalit themeltar të shoqërisë së sigurimit INTERSIG sh.a. në zbatim të kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe detyrimeve që burojnë nga përgjegjësitë e marra në sigurim.

2. Rritjen e vlerës së provigjoneve teknike në shumën 191 122 321 lekë të miratuar me vendimin e Këshillit të Autoritetit Mbikëqyrës së Sigurimeve nr.20, datë 1.4.2005.

3. Në zbatim të nenit 128 të ligjit 9267, datë 29.7.2004 në rast se shoqëria INTERSIG sh.a. nuk i plotëson masat e parashikuara në këtë vendim, Autoriteti do të procedojë me masën e tërheqjes së licencës për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimeve.

4. Vendimi të shqyrtohet nga organet drejtuese të shoqërisë dhe masat e marra në zbatim të tij t'i njoftohen Autoritetit.

Ky vendim hyn në fuqi më 27.9.2005.

KRYETARE E KËSHILLIT
TË AUTORITETIT MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE
Burbuqe Riba